



---

## **E K S T R A K T**

**i mbledhjes së gjashtë të Komitetit për Komunitete, mbajtur më 18.6.2025, me fillim në orën 10:00.**

**Në mbledhje morën pjesë:** Mirsada Behluli, Nenad Miladinovic, Elmira Nikçi-Rexha, Oktay Kurtesh, Kimeta Shok, Adnan Ajeti, Triera Kasumi- Berisha.

**Munguan:** Arton Brahim, Faton Marolli.

**Në mbledhje morën pjesë edhe:** Klaudia Mula- zyrtare për komunitete nga ZKKK-ës, Slavica Stolic-zyrtare nga ZKKK-ës, Arianita Beqa Rraci- zyrtare nga UNMIK-u, përfaqësuesit e KFOR-it.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi kryesuesja e komitetit znj. Mirsada Behluli me këtë;

### **R E N D D I T E:**

- 1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga seanca e fundit e Komitetit për Komunitete;**
- 2. Ftesë për drejtoreshën e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale të Komunës së Prishtinës;**
  - a) Raport mbi numrin e rasteve sociale nga komunitetet jo shumicë (serbë, ashkali, romë, boshnjak, turq dhe goranë);**
- 3. Ftesë për drejtoreshën e Drejtorisë së Financave të na informoj lidhur me ndarjen e buxhetit për vitin 2026;**
- 4. Ftesë për drejtorin e Drejtorisë së Inspeksionit;**
  - a) Deponi të paligjshme, b) ndërtime të paligjshme, etj;**
- 5. Ftesë për drejtoreshën e Drejtorisë së Parqeve; ( planet e punës së Drejtorisë për vitin 2025;**
- 6. Formimi i Komisionit për hartimin e raportit gjashtëmujor të punës së Komitetit për Komunitete;**
- 7. Formimi i Komisionit për hartimin e raportit gjashtëmujor të punës së ZKKK-ës;**
- 8. Raportimi i përfaqësuesve të komuniteteve jo shumicë mbi situatën në komunitetin e tyre (duke pasur parasysh që duhet të përgatisim raportin gjashtëmujor të punës së Komitetit për Komunitete, do të kërkoj që secili përfaqësues i komuniteteve jo shumicë të përgatisë dhe t'i paraqes kërkesat dhe nevojat specifike të komunitetit të tij;**

## **9. Të ndryshme;**

Me propozimin e kryesueses së komitetit që pika e shtatë të hiqet nga rendi i ditës dhe që pika e tetë të del si pikë e shtatë, njëzëri u miratua rendi i ditës.

### **Pika e parë**

**Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga seanca e fundit e Komitetit për Komunitete.**

Njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

### **Pika e dytë**

**Ftesë për drejtoreshën e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale të Komunës së Prishtinës;**

**a) Raport mbi numrin e rasteve sociale nga komunitetet jo shumicë (serbë, ashkali, romë, boshnjak, turq dhe goranë).**

Për shkak të moskonfirmimit të pjesëmarrjes në takim nga ana e drejtorisë përkatëse kjo pikë e rendit të ditës shtyhet për njëzëri nga takimet e ardhshme.

### **Pika e tretë**

**Ftesë për drejtoreshën e Drejtorisë së Financave të na informoj lidhur me ndarjen e buxhetit për vitin 2026.**

Për shkak të moskonfirmimit të pjesëmarrjes në takim nga ana e drejtorisë përkatëse kjo pikë e rendit të ditës shtyhet për njëzëri nga takimet e ardhshme.

### **Pika e katërt**

**Ftesë për drejtorin e Drejtorisë së Inspektionit;**

**a) Deponi të paligjshme, ndërtime të paligjshme etj.**

Për shkak të moskonfirmimit të pjesëmarrjes në takim nga ana e drejtorisë përkatëse kjo pikë e rendit të ditës shtyhet për njëzëri nga takimet e ardhshme.

### **Pika e pestë**

Për shkak të moskonfirmimit të pjesëmarrjes në takim nga ana e drejtorisë përkatëse kjo pikë e rendit të ditës shtyhet për njëzëri nga takimet e ardhshme.

## **Pika e gjashtë**

### **Formimi i komisionit për hartimin e raportit gjashtëmuor të punës së Komitetit për Komunitete.**

Për anëtarë të komisionit për hartimin e raportit gjashtëmuor të punës së Komitetit për Komunitete u propozuan Nenad Miladinovic, Elmira Nikçi- Rexha, Mirsada Behluli dhe një nga zyrtarët e ZKKK-ës të cilin e propozon ZKKK-ës.

## **Pika e shtatë**

### **Raportimi i përfaqësuesve të komuniteteve jo shumicë mbi situatën në komunitetin e tyre (duke pasur parasysh që duhet të përgatisim raportin gjashtëmuor të punës së Komitetit për Komunitete, do të kërkoj që secili përfaqësues i komuniteteve jo shumicë të përgatisë dhe t'i paraqes kërkesat dhe nevojat specifike të komunitetit të tij.**

**Kimeta Shok:** – sa i përket komunitetit goran nuk kemi probleme vetëm se desha të them se pasi gjithnjë kemi kritika lidhur me mbeturinat në qytet mund të them se tani gjendja është përmirësuar sidomos në pjesën ku unë jetoj. Po ashtu edhe ndriçimi është rregulluar.

**Nenad Miladinovic:** – sa i përket problemeve dhe kërkesave tha se unë zakonisht të gjitha problemet dhe kërkesat i kam shtruar në takimet tona po ashtu shpeshherë kam takime edhe me përfaqësuesit e KFOR-it, me policinë e Kosovës ashtu që me ato probleme të gjithë janë të njoftuar.

Ai në vazhdim shtroi shqetësimin lidhur me deponit ilegale pastrimin e shtratit të lumit si dhe me numrin e madh të qenve endacak në Bërnice të Poshtme, ku për këtë i adresohet Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

Ai mes të tjerash cekti edhe ndërprerjen e punimeve në projektin i cili ka filluar qysh në vitin 2022, për të cilin kanë qenë të siguruara mjetet, e ajo ka të bëjë me asfaltimin e rrugës kryesore në Bërnice të Poshtme e cila ka të bëjë me gjatësi 2.5 kilometra dhe është e frekuentueshme mjaft pasi që aty ndodhet edhe stacioni i autobusëve. Ai në vazhdim tha se aty është ndërtuar ura para 15 viteve dhe se hyrja deri tek ura nuk është e rregulluar e kjo ka të bëjë me Drejtorin e Investimeve Kapitale. Si dhe sa i përket meje ky projekt nuk është kryer dhe se kush ka qenë mbikëqyrës i këtij projekti nuk e di por për fat të keq kjo punë nuk ka përfunduar.

Ndërsa sa i përket sigurisë tha se sa i përket marëdhënieve ndëretnike në Bërnice janë korrekte dhe të mira gjë që për mua është shumë e rëndësishme.

Meqë kemi pasur një rast të familjes Vanic që ka pasur të bëjë me kontestin për shkak të pasurisë së paluajtshme ku rasti është në gjykatë dhe shpresoj se gjykata do ta zgjidhë këtë problem në të mirë.

**Adnan Ajeti:** – shtroi problemin lidhur me ujësjellësin i cili nuk i përgjigjet ftesës së shtruar nga ana e banorëve të lagjes ku ai jeton.

**Triera Kasumi Berisha:** - lidhur me shqetësimin e z. Ajeti tha se pasi jam banore e asaj lagje edhe unë po e marr për sipër që të kontaktoj me kompaninë e ujësjellësit dhe besoj se do të vijmë dhe ta zgjidhin problemin.

**Oktay Kurtesh:** - sa i përket sigurisë nuk kemi dhe as nuk kemi pasur probleme vetëm se kemi pasur kërkesa qysh edhe tani kam një kërkesë që ka të bëjë me fillimin e punës në rrugën “Agim Ramadani ” tek xhamia ku është gropuar një pjesë të rrugës diku pesë metra dhe nuk ka përfunduar por ka mbetur ashtu e hapur vetëm se është rrethuar dhe nuk ka vendkalim për qytetarë e që duhet me dal në rrugë për me kaluar atë pjesë.

Ai në vazhdim cekti edhe çështjen e drunjëve kinez që ju kanë thënë, e të cilët janë mbjellur në kohën e Shpend Ahmetit d.m.th para dhjetë viteve e që janë të dëmshme për shëndetin e njeriut kisha me kërkuar që mundësisht ato të prehen.

**Elmira Nikçi Rexha:** - tha se sapo kontaktova me Drejtorin e Investimeve Kapitale dhe se gropën e lartëpërmendur tek xhamia nuk e ka hapur ajo por e ka hapur KEDS-i për me i futur gypat ndër tokë.

Pra, tani komuna nuk ka qasje për ta bërë mbylljen por më premtuan se tani do ta kontaktojnë KEDS-in që ta lejojnë për t'a sanuar atë gropë, pra të vënë ndonjë mjet metalik dhe ta mbyllin.

**Nenad Miladinovic:** – duke u ndërlidhur në diskutim tha se pasi që do të punohet raporti gjashtëmujor i punës i kam lëshuar pa i përmendur dy projekte për të cilat kemi pasur dy kërkesa njëra ka të bëjë me rregullimin e parkingut para kishës qysh nga viti 2021, kurse kërkesa tjetër është furnizimi me ujë nga ujësjellësi në fshatin Slivovë në lagjen e epërme projekt që është nga viti 2022. Pra këto dy projekte janë që nga viti 2021/2022.

**Mirsada Behluli:** – duke u ndërlidhur në diskutimin e z. Miladinovic tha se do ti kem parasysh që të hyjnë në raport edhe këto dy kërkesa si dhe besoj se drejtorit përkatëse do ti marrin parasysh.

## **Pika e tetë**

### **Të ndryshme**

**Nenad Miladinovic:** – sa i përket kësaj pike të rendit të ditës tha se vitin e kaluar kemi pasur festivalin në muajin gusht i cili është mbajtur në territorin e Bërnics së Poshtme, ku po ashtu edhe këtë vit i njëjti festival do të organizohet në fillim të muajit gusht.

Ai në vazhdim tha se kisha me apeluar tek organet kompetente të komunës si dhe tek dy koleget tan që janë përfaqësuese të asamblesë komunale në këtë komitet që Komuna e Prishtinës të angazhohet në rregullimin e vendit ku do të mbahet festivali e jo siç ka qenë vitin e kaluar aty ka qenë deponia më e madhe që është turp për Komunën e Prishtinës që njerëzit ta shohin atë.

**Adnan Ajeti:** – tha se këtë vit nuk kemi mundur ta festojmë ditën e romëve pasi që Komuna e Prishtinës nuk na ka ndihmuar asgjë.

**Elmira Nikçi Rexha:** – shtroi pyetje për z. Ajeti se a është bërë kërkesa për financim.

**Adnan Ajeti:** – duke iu përgjigjur znj. Nikçi- Rexha, tha se kërkesa është bërë por nuk është realizuar.

**Klaudia Mula:** – duke u ndërlidhur në diskutim, tha se ju keni bërë kërkesë përmes një organizate dhe keni dashur që manifestimi të bëhet në Graçanicë, kështu që Komuna e Prishtinës nuk financon diçka çka nuk manifestohet në Prishtinë.

Ajo në vazhdim tha se aplikimi për manifestime është online në Drejtorin e Kulturës në Komunën e Prishtinës.

Ajo mes tjerash tha se ne si zyre gjithnjë ndërmjetësojmë që të përkrahen festat kombëtare të të gjithëve.

**Triera Kasumi Berisha:** – tha se në takimin e kaluar e kemi diskutuar se pas përfundimit të mbledhjes të caktojme një takim të mundshëm me kryetarin e komunës dhe se a duhet unë dhe Ema ta cekim raportin e punës së komitetit si pikë të rendit të ditës në asamble, çka po ndodh me atë proces pasi që jemi në fund të këtij mandati.

Ajo në vazhdim shtroi pyetje se a duhet të bëjmë kërkesë për diskutim në Kuvend apo duhet vetëm të paraqesim raportin.

**Mirsada Behluli:** – duke iu drejtuar znj. Kasumi- Berisha, tha se në çdo gjashtë muaj kemi paraqitur raportin e po ashtu edhe raportin vjetor ku aty kemi cekur të gjitha problemet dhe kërkesat e komuniteteve jo shumicë, ku të gjitha organet kompetente e kanë pranuar duke filluar nga kryetari e deri tek drejtorët.

**Elmira Nikçi Rexha:** – duke u ndërlidhur në diskutim tha se në takimin e kaluar që e kemi pasur e kam marr një lloj obligimi edhe pse kryesuesja ka trokitur nëpër dyer por secila pjesë e ka protokollin e vet, unë e kam marr obligim me biseduar me kryetarin nuk është ndier mirë për atë që drejtorët nuk janë përgjigjur por decidiv e ka ftuar asistenten e vet dhe e ka parë se ka pasur email zyrtar prej kryesueses për takim personal me kryetarin për me ngritur si çështje. Ajo në vazhdim tha se vet kam qenë dëshmitare se kapasur emaila nga ana e kryesueses por jo për takim personal apo diçka tjetër për me e ngritur si çështje apo ankesë ndaj kabinetit. Kryetari e pati një kërkesë që kryesuesja në emër të komitetit të dërgon email zyrtar për takim, ku pastaj aty mundemi t'a zgjidhim çështjen e drejtorëve.

**Nenad Miladinovic:** – tha se sa i përket propozimit të Trierës që të bëhet kërkesë nga Kuvendi i Komunës për raportin si pikë e rendit të ditës, dhe mendoj se nuk ka nevojë sepse nuk është në praktikë pasi edhe vet kam qenë asamblist dhe e di se si shkonë puna. Pra, mendoj se është joreale që të jetë pikë e rendit të ditës raporti me kërkesë nga ky komitet, vetëm ajo çka është reale siç tha edhe Ema që së pari të bisedohet me kryetarin.

Pra pas ca diskutimesh, sugjerimesh dhe propozimesh është arritur marrëveshja që të caktohet një takim zyrtar me kryetarin dhe kryesuesen së bashku me disa anëtarë të komitetit.

Procesmbajtësja  
Lendita Spahija

Kryesuesja e Komitetit  
Dr. Mirsada Behluli

*M. Behluli*



---

Faqe 6 nga 6

Adresa: Rr. UÇK- 2-10.000 Prishtinë-Kosovë  
Telefon: + 381(0)38/230-900  
<http://www.prishtina-komuna.org>